



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 13, 58 shkronja f), 62.2 dhe 66.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14, 16, 61 paragrafët 1.6 dhe 1.7 si dhe 64 paragrafët 2 dhe 3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01 -0050862/18, të datës 29 qershor 2018, merr:

V E N D I M

PËR LIRIMIN NGA DETYRA E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË DREJTORISË SË BUXHETIT DHE FINANCAVE

Neni 1

- **z.Fatlum Osmani**, lirohet nga detyra e ushtruesit të detyrës së drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Neni 2

Lirimi nga detyra e ushtruesit të detyrës së drejtorit sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhet në kërkesë të të njëjtit për arsye personale .

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të përmendurit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-118/02-0000245/26
Podujevë, Dt; 05.01.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Buliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenin 19.2 të Ligjit për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr. 01-020/01-0050862/18, jep këtë:

AUTORIZIM

Autorizohet **znj. Haxhere Ajvazi**, zyrtare e lartë për buxhet dhe financa në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave-DBF për përdorim zyrtar dhe ruajtje të vulës nga kompetenca, fushë veprimtaria dhe përgjegjësitë e DBF.

Autorizimi jepet për kohë të pacaktuar, përkatësisht deri në emërimin e Drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe financave, apo deri ndonjë akt tjetër administrativ.

Nr. prot. 02-016/01-0000247/26
Podujevë, datë: 05.01.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 13 dhe 58 shkronja e) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe 61 parag. 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Bahri Selimi, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, autorizohet të veprojë dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga fushëveprimtaritë dhe kompetencat e Drejtorive të Administratës komunale, në të cilat ende nuk janë bërë emërimet e drejtorëve.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij Vendimi vlen deri në emërimin e drejtorëve në Drejtoritë përkatëse të Komunës së Podujevës, apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Të përmendurit
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-016/01-0000547/26
Podujevë, datë: 06.01.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 parag. 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Neni 1

z.Ahmet Ahmeti, me kualifikim jurist, nga fshati Llapashticë e Poshtme-Komuna e Podujevës, emërohet;

- **Ushtrues i Detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM**

Neni 2

I përmenduri në funksionin e cekur emërohet në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-112/02-0000544/26
Podujevë, datë: 06.01.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 13 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr.01-020/0050862/18, merr këtë:

V E N D I M PËR PEZULLIMIN E VENDIT TË PUNËS

- I. Pezullohet sipas detyrës zyrtare marrëdhënia e punës e Ahmet Ahmeti, zyrtar i lartë për të drejtat e njeriut në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Podujevës duke filluar nga data e emërimit në Ekzekutivin e Komunës së Podujevës, Ushtrues Detyre i Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
- II. Pezullimi vlen deri sa i përmenduri është i emëruar në kuadër të Ekzekutivit të Komunës.
- III. Gjatë periudhës së pezullimit Ahmet Ahmeti gëzon të drejtat sipas Ligjit për Zyrtarët Publik në fuqi, përfshirë ruajtjen e vendit të punës, pa pagesë.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Personelit.

Arsyetim

Ahmet Ahmeti, zyrtar i lartë për të drejtat e njeriut në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Podujevës, më 06.01.2026 me Vendimin nr. Prot. 02-112/02-0000544/26 është emëruar Ushtrues Detyre i Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Podujevës dhe i njëjti ka paraqitur kërkesë nr. Prot.02-118/02-0001478/26, datë 08.01.2026 për pezullim të marrëdhënies së punës sipas detyrës zyrtare.

Sipas legjislacionit në fuqi përkatësisht neneve **69 paragrafi 1.2** dhe **71** të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, pas emërimit në kuadër të Ekzekutivit të Komunës të njëjtit i pezullohet marrëdhënia e punës si zyrtar i lartë për të drejtat e njeriut në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Podujevës, pa pagesë sipas detyrës zyrtare.

Pas përfundimit të funksionit në kuadër të Ekzekutivit të Komunës i përmenduri kthehet në pozitën e mëparshme të punës.

Nga se u cek u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi lejohet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Me këtë vendim njoftohen:

z. Ahmet Ahmeti
Zyra e Personelit
QSHQ Arkiva

Nr.prot.02-016/01-0001821/26
Podujevë, datë: 09.01.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 13 dhe 58 shkronjat f) dhe g) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14, 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, jep këtë:

AUTORIZIM

I.

znj. Mimozë Restelica Sejdiu, zyrtare për zhvillim në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, autorizohet për kryerjen e punëve dhe detyrave si dhe koordinimin e aktiviteteve nga fushëveprimi i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave të Komunës së Podujevës, deri në emërimin e drejtorit të Drejtorisë së cekur.

II.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Të përmendurës
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-112/02+0002705/26
Podujevë, datë: 13.01.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr.03/L-040, nenet 16, 61 paragrafi 1.6 dhe nenin 64 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E USHTRUESIT TË DETYRËS SË DREJTORIT TË DREJTORISË SË BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Neni 1

z.Behram Latifi, me kualifikim jurist, nga fshati Bradash Komuna e Podujevës, emërohet;

- **Ushtrues i Detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

Neni 2

I përmenduri në funksionin e cekur emërohet në kohëzgjatje të mandatit të Kryetarit të Komunës, apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


I dërgohet:
Të emëruarit
Zyrës së personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-112/02-0003885/26
Podujevë, datë: 19.01.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 7 dhe 9 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës së znj. Lindita Ymeri, Menaxhere për Zhvillimin e kapaciteteve në Asociacionin e Komunave të Kosovës-AKK, për themelimin e Grupit të përfaqësuesve nga komuna, merr:

V E N D I M

Neni 1

Themelohet Grupi i përfaqësuesve nga Komuna e Podujevës për zbatimin e aktiviteteve të parapara me Projektin ReLOaD3, në këtë përbërje:

-Rilind Babatinca, zyrtar për pranim në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, E-mail: rilind.babatinca@rks-gov.net; tel: +3834 [REDACTED]

-Blerta Ajvazi, zyrtare për regjistrim të bizneseve në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, E-mail: blerta.ajvazi@rks-gov.net; tel: +3834 [REDACTED]

Neni 2

1. Grupi i përfaqësuesve nga Komuna do të fillojnë bashkërisht zbatimin e aktiviteteve të parapara me projektin ReLOaD3 në përputhje me nenin 7 dhe 9 të Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve; si dhe metodologjinë LOD, ekipi i projektit do të bashkëpunojë gjatë gjithë fazave të zbatimit të projektit; do të njoftojë rregullisht Kryetarin me ecurinë e aktiviteteve të projektit si dhe do t'i kryejë edhe punët tjera që kërkohen për projektin e cekur.

2. Grupi i përfaqësuesve për zbatimin e aktiviteteve të parapara të projektit ReLOaD3 ka për obligim që bashkëpunojë me ekipin e projektit gjatë të gjitha fazave të zbatimit.

3. Anëtarët e grupit të përfaqësuesve do të kenë rol në Komisionin vlerësues të projekt-propozimeve; në Komisionin e ankesave dhe në Komisionin për monitorim dhe raportim të projekteve.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Anëtarëve të Komisionit
znj. Lindita Ymeri-AKK
QSHQ/Arkivës

Nr.prot. 02-020/05-0004244/26
Podujevë, datë: 20.01.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 14 të Ligjit nr.08/L-103 për sistemin e menaxhimit të performancës së Komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë, Udhëzim Administrativ (MAPL) nr.01/2023 për menaxhimin e performancës komunale dhe skemën e grantit për performancë komunale, dhe neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës nxjerrë këtë;

V E N D I M

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT Nr.Prot.02-020/04-0008688/25

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr.prot.02-020/04-0008688/25 i datës 06.02.2025 për caktimin e koordinorit për performancë si dhe zyrtarëve raportues për fushat e performancës në Komunën e Podujevës, dhe atë:

z.Remzi Kodraliu, zyrtar për regjistrimin e adresave, në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrotjes së Mjedisit, caktohet anëtar i Komisionit në fjalë, *Fushat 8 dhe 12-Hapësirat Publike; Mbrotjtja e Mjedisit*, në vend të ish anëtares znj.Artiola Zeneli e cila ka kaluar në punë dhe detyra tjera të punës në një institucion tjetër.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti është pjesë përbërëse e Vendimit nr.prot. 02-020/04-0008688/25 të datës 06.02.2025.

U dërgohet;

Të emëruarës dhe anëtarëve (përmes koordinorit)

QSHQ / Arkivës

Nr.Prot.02-020/04-0004240/26
Podujevë, datë: 20.04.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Duke u mbështetur në nenin 13, ndërlidhur me nenin 58 shkronja g) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, dispozitat e Ligjit nr.08/L-125 për pronën publike, Rregulloren (QRK) nr.04/2025 për mënyrën e mbajtjes së evidencës së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe e regjistrimit të sendeve në pronësi publike, nenin 16 ndërlidhur me nenin 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe sipas Shkresës nr.prot.1264 datë 23.12.2025 të Zyrës për Administrimin e Pronës Publike në kuadër të Zyrës së Kryeministrit-ZKM, nxjerrë këtë;

V E N D I M

Neni 1

Me qëllim të Raportimit të të dhënave për pronat publike të luajtshme dhe të paluajtshme në territorin e Komunës së Podujevës, të cilat administrohen ose shfrytëzohen nga Komuna e Podujevës, koordinimit efikas të këtij procesi si dhe komunikimit të drejtpërdrejt me Zyrën për Administrimin e Pronës Publike në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, caktohet zyrtarja përgjegjëse;

➤ **znj.Ardiana Dibrani**, Udhëheqëse e Sektorit të Pronës në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, në Komunën e Podujevës.

E-mail: ardiana.dibrani@rks-gov.net

Nr. tel: VOIP: 038 / 200 41059

Mobil: +383 4

Neni 2

Zyrtarja e caktuar me këtë vendim, për punët dhe detyrat e parapara me dispozitat përkatëse të Ligjit nr.08/L-125 për Pronën Publike si dhe akteve nënligjore përkatëse, ndër të tjera koordinon dhe komunikon drejtpërdrejt me Zyrën për Administrimin e Pronës Publike në kuadër të ZKM-së, sa i përket raportimit me të dhëna të sakta, të plota dhe të verifikueshme si dhe çështje tjera të parapara me Ligjin në fjalë lidhur me pronat publike të luajtshme dhe të paluajtshme brenda territorit të Komunës së Podujevës të cilat janë në administrim apo shfrytëzim nga Komuna e Podujevës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: tokat, ndërtesat, objektet infrastrukturore dhe asetet tjera të paluajtshme, statusin e tyre juridik, përdorimin aktual, dokumentacionin pronësor përkatës, vlerën e tyre si dhe të dhënat kadastrale në përputhje udhëzimet përkatëse teknike.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë njoftohen:

Ardiana Dibrani

Zyra për Administrimin e Pronës Publike - ZKM

Zyra e Personelit

QSHQ / Arkivi

Nr.Prot. 02-463/06-0004719/26
Podujevë, datë: 21.01.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Mahmut Ajvazi, zyrtar për ndërtimtari në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se tre (3) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 3

E përmendura deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari
Drejtoria e Inspeksionit
Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-016/01-0006214/26
Podujevë, datë: 29.01.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.02-400/04-0006016/26 të datës 28.01.2026, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Azem Hamza, nga fshati Dobratin Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore i jepet ndihmë financiare në shumë 1000 €.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Azem Hamza (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/01-0006016/26
Podujevë, datë, 30.01.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 15 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të datës 29.01.2026, të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.02-400/04-0003831/26 të datës 16.01.2026, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Erjona Jashari, nga fshati Dumnicë e Poshtme Komuna e Podujevës, për vijimin e rregullt të shkollimit në fakultetin e mjekësisë në Tiranë, mbështetet me mjete financiare në shumë 700.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Arsimit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

znj.Erjona Jashari (njoftohet përmes DKA-së).

Nr.prot 02-400/01-0006484/26
Podujevë, datë, 30.01.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.02-400/04-0002037/26 të datës 12.01.2026, merr:

VE N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Liridonë Uka Ademi, nga fshati Pollatë, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve mjekësore i jepet ndihmë financiare në shumë 1000 €.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

znj.Liridonë Uka Ademi (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/01-0006493/26
Podujevë, datë, 30.01.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 paragrafi 1.13 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot.09-615/03-0005587/26 të datës 27.01.2026, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Shqipdon Rushiti, nga Podujeva, me rastin e përvjetorit të rënies së heronjve Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, për organizimin e koncertit përkujtimor “Jehonë Lirie”, në nderim të veprës së tyre, mbështetet me mjete financiare në shumë 3000€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurit i cili ka për obligim që pas përfundimit të manifestimit të ditës koncertit të dorëzoj raport lidhur me shpenzimet financiare.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Shqipdon Rushiti (njoftohet përmes DKRS-së).

Nr.prot 02-400/01-00064 81/26
Podujevë, datë, 30. 01. 2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e Kërkesës nr.prot.02-400/04-0002813/26 të datës 14.01.2026, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Illir Havolli, nga fshati Herticë, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të djalit të tij (Lorian Havolli) dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor si dhe gjendjes së rënduar ekonomiko-sociale i jepet ndihmë financiare në shumë 500€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Illir Havolli (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot. 02-400/01-0006482/26
Podujevë, datë 30.01.2026


Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi